VENDIM
Nr.292, datë 12.3.2009

PËR DHËNIE SHTESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.MIRUSH DELIALLISI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Mirush Deliallisi, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit, që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha